



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE**

**SHPLLJE PËR NJË VËND TË LIRË PUNE PËR KATEGORINË E
PUNONJËSVE MBËSHTETËS-MIRËMBAJTËS TEKNIK**

Në zbatim të nenit 12, të Ligjit nr.8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin e funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, të ndryshuar, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë shpall procedurën e plotësimit të vëndit të lirë të punës në kategorinë punonjës mbështetës:

1(një) punonjës të mirëmbajtjes teknike me kontratë pune në Sektorin e Shërbimeve të administratës së Gjykatës Kushtetuese.

Vëndi i punës më sipër u ofrohet të gjithë kandidatëve që plotësojnë kërkesat e kategorisë së punonjësve mbështetës për mirëmbajtës teknik.

Data e fillimit të njoftimit:

16 shkurt-2017

Data e mbarimit të njoftimit:

17 mars-2017

Data e fundit e dorëzimit të dokumentave:

17 mars-2017

Përshkrimi përgjithësues i punës për kategorinë e punonjësve mbështetës si më sipër është:

Vendi i punës “Punonjës Mirëmbajtës teknik”, kërkon:

1) Qëllimi i pozicionit të punës:

1.1)Të mirëmbajë nga ana teknike paisjet dhe ambjentet e selisë së Gjykatës Kushtetuese për të siguruar gatishmërinë teknike të tyre në funksion të veprimtarisë normale të institucionit.

2) Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- 2.1) Ka varësi të drejtpërdrejtë nga përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve dhe raporton e përgjigjet para tij për realizimin në afat të detyrave funksionale dhe detyrave të tjera të ngarkuara nga ai.
- 2.2) Të mirëmbajë dhe riparojë të gjitha defektet e konstatuara në paisjet e inventarin e gjykatës, në sistemin elektrik, hidrosanitar, marangoz, kondicioner, lyerje e shërbime të ndryshme në zyrat, sallat dhe mjediset e tjera të brendshme e të jashtme të gjykatës.
- 2.3) Të bëjë lëvizje e transporte të ndryshme të paisjeve, inventarit, materialeve orendive të zyrave, furniturave etj. sipas nevojave të sektorit, magazinës etj.
- 2.4) Të zbatojë me korrektësi të gjitha rregullat e sigurimit teknik të punës dhe pajisjeve, konform rregullave e legjislacionit në fuqi në R.SH.
- 2.5) Të mirëmbajë njetin elektrik të furnizimit të brendshëm me energji elektrike për ndriçimin, pajisjet ndriçuese dhe pajisjet e tjera në mjediset, zyrat e godinën e gjykatës.
- 2.6) Të mbajë lidhje të drejtpërdrejta me teknikun elektrik të OSHEE-së, si dhe të Kuvendit që përgjigjet për kabinat elektrike në Kuvend, për riparimin e defekteve, dhe të riparojë defektet që vijnë si rezultat i furnizimit të njetit të brendshëm elektrik të gjykatës.
- 2.7) Të mbajë në gatishmëri pajisjet e MKZ dhe të njoftojë përgjegjësin jo më vonë se 30 ditë para afatit të skadimit të pajisjeve të MKZ-së.
- 2.8) Të mbajë në gjendje gatishmërie dhe të kontrollojë me eficiencë pajisjet dhe agregatet e sistemeve të ndryshme të furnizimit me energji elektrike alternative, ajrit të kondicionuar, kaldaja, etj. që sigurojnë kushtet normale të punës në gjykatë dhe në mjediset e jashtme të saj.
- 2.9) Të vërë në funksionim kondicionerët e ajrit të sallës së gjyqit 1 orë para fillimit të seancave gjyqësore, në funksion të temperaturave dhe kushteve konkrete të motit.
- 2.10) Të menaxhojë përdorimin e ujit të depozitave të gjykatës për sigurimin e pandërprerë të furnizimit me ujë të institucionit.
- 2.11) Të qëndrojë në gatishmëri të plotë për të ndërhyrë për mbajtjen në funksionim të plotë të paisjeve gjatë gjithë kohës që zhvillohet seanca gjyqësore në sallë.
- 2.12) Të mbajë lidhje të drejtpërdrejta me teknikët përgjegjës të telekomit e subjektet e licensuara dhe të marrë masa për eliminimin e defekteve të numrave telefonikë fix, si dhe të centralit e njetit të brendshëm telefonik.
- 2.13) Të kryejë çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga eporet në përputhje me profilin e tij të punës.

3) Marrëdhëniet organizative

- 3.1) Punonjësi i mirëmbajtjes teknike ka varesi të drejtpërdrejtë nga Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve. Ai/ajo, gjithashtu raporton sipas kërkeses tek Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe Burimeve Njerezore. Punonjësi i mirëmbajtjes teknike bashkëpunon me punonjësit e tjere mbështetës të sektorit për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi që i janë ngarkuar.

4) Kërkesat e vendit të punës

- 4.1) Të ketë një figurë të pastër morale.
- 4.2) Të ketë aftësi të mira komunikimi.
- 4.3) Të jetë i/e gatshëm të punojë jashtë orarit (kur është e nevojshme).
- 4.4) Të mos jetë i denuar me vendim të formës së prirë të gjykatës.
- 4.5) Të ketë kryer shkollën e mesme. Preferohet shkolla profesionale.
- 4.6) Të ketë profesion baze dhe të jetë i aftë dhe i kualifikuar për të punuar:
 - 4.6.1) Punime ndertimi (murator-teknik ndertimi-hidraulik).
 - 4.6.2) Punime druri (marangoz).
 - 4.6.3) Punime elektrike (elektrici).
 - 4.6.4) Etj. sipas natyrës së punës që do të kryejë.
- 4.7) Të jetë i çertifikuar në profesionet e mësipërme.

4.8) Të ketë përvojë pune mbi 3 vjet në profesionet e mësipërme. Preferohen profesionet hidraulik dhe elektrikist.

4.9) Mirëmbajtësi teknik preferohet të ketë moshën 20-55 vjeç.

5) Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit.

5.1) Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë Ekonomike dhe të Burime-ve Njerëzore të Gjykatës Kushtetuese në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr.26, Tiranë, dokumentat e mëposhtme:

5.1.1) *Kërkesën për aplikim;*

5.1.2) *Curriculum Vitae të përditësuar me datën dhe firmën e personit;*

5.1.3) *Fotokopjen e kartës së identitetit;*

5.1.4) *Vërtetim papunësie lëshuar nga Zyra e Punës ose fotokopje e librezës së punës në rast se është i punësuar;*

5.1.5) *Vlerësim të punës nga punëdhënësi i fundit;*

5.1.6) *Vërtetimin e banimit të lëshuar nga zyra e gjendjes civile përkatëse;*

5.1.7) *Fotokopje e diplomës së Shkollës së Mesme.*

5.1.8) *Fotokopje e librezës së punës.*

5.1.9) *Vërtetimi i gjendjes gjyqësore ose formulari i plotësuar për lejimin e kontrollit të gjendjes gjyqësore në mënyrë elektronike nga institucioni.*

5.1.10) *Vërtetim të gjendjes shëndetsore(raport mjeko-ligjor nga komisioni i qëndrës ku banon)*

5.1.11) *Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.*

5.2) Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 17.03.2017.

6) Faza e parë e seleksionimit do të bëhet nëpërmjet dokumentave.

6.1) Në datën 20 mars 2017, ora 14:00, do njoftohen kandidatët që janë kualifikuar nga seleksionimi, nëpërmjet njoftimit në këndin e njoftimeve publike të gjykatës ose në faqen e internetit të saj.

6.2) Më datën 24 mars 2017, ora 12:00, do të kryhet një testim paraprak në formën e intervistës me personat e kualifikuar në fazën e parë të seleksionimit.

7) Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista.

7.1) Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- *Njohuri të përgjithshme për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;*
- *Njohuri të përgjithshme për Ligjin nr.8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin e funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, te ndryshuar;*
- *Njohuri të përgjithshme për Kodin e punës për te drejtat e detyrimet e punedhenesit e punemarresit;*
- *Njohuri për Rregulloren e Brëndshme të Gjykatës Kushtetuese për organizimin e Gjykatës Kushtetuese, te drejtat e detyrat e punonjesve mbeshtetes, disiplinën në punë dhe masat disiplinore etj;*

8) Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

8.1) Kandidatët do të vlerësohen nga “Komisioni i brendshëm”, i ngritur pranë institucionit të Gjykatës Kushtetuese. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht: 60 pikë për dokumentacionin dhe 40 pikë për intervistën e strukturuar me gojë.

8.2) Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, përvojat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive sipas dokumentacionit të dorëzuar i ndarë si më poshtë:

- 10 pikë jetëshkrimi;
- 10 pikë për eksperiencën e përgjithshme;
- 10 pikë për eksperiencën profesionale
- 20 pikë për kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse;
- 10 pikë për vlerësimet pozitive.

8.3) Kandidatët për intervistën e strukturuar me gojë do të vlerësohen me 40 pikë në lidhje me:

- *Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e vëndit të punës;*
- *Përvojën e tyre të mëparshme;*
- *Njohuri të përgjithshme për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;*
- *Njohuri të përgjithshme për Ligjin nr.8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin e funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, te ndryshuar;*
- *Njohuri të përgjithshme për Kodin e Punës per te drejtat e detyrimet e punedhënesit e punemarresit;*
- *Njohuri për Rregulloren e Brëndshme të Gjykatës Kushtetuese per organizimin e Gjykes Kushtetuese, te drejtat e detyrat e punonjesve mbeshettes, disiplinen ne pune dhe masat disiplinore etj;*
- *Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për punën.*

9) Afatet, data e nxjerrjes së rezultateve të përzgjedhjes dhe mënyra e komunikimit

9.1) Faza e parë e seleksionimit do të bëhet nëpërmjet dokumentave.

9.2) Në datën 20 mars 2017, do përfundojë seleksionimi dhe do të njoftohen kandidatët që janë kualifikuar nga seleksionimi.

9.3) Më datën 24 mars 2017, do të kryhet një testim paraprak në formën e intervistës me personat e kualifikuar në fazën e parë të seleksionimit.

9.4) Lista e rezultateve të kandidatëve pjesëmarrës dhe e fituesit do të do të shpallen më datën 30 mars 2017, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës Kushtetuese dhe në këndin e njoftimeve publike të institucionit.

Për sqarime, mund të kontaktoni me numrin e telefonit 4 2243 698 ose në adresën:
Gjykata Kushtetuese, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr.26,Tiranë.

GJYKATA KUSHTETUESE

Tirane, me, 15.02.2017